



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 6190 prot.

Ballsh më, 26.12 .2024

VENDIM

Nr. 62 Datë 24 / 12 / 2024

**“PËR
MIRATIMIN E KOMPENSIMIT TË SHPENZIMEVE TË TRANSPORTIT PËR
NXËNËSIT PËR VITIN SHKOLLOR 2024 - 2025”**

Në zbatim të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak Mallakastër nr. 65, datë 21.12.2023 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2024”, si dhe konstatimet e kryera mbi vështirësitë e lëvizjes në akset rrugore të mëposhtme dhe për të garantuar mundësimin që fëmijët/nxënësit e këtyre shkollave të zhvillojnë një proces normal mësimor”,

VENDOSI

1. Kompensimin e shpenzimeve të transportit në masën 100 (njëqind) lekë / nxënës për çdo ditë për vitin shkollor 2024-2025, në linjat e mëposhtme:

- Selitë - Shkolla 9 – Vjeçare Fratar
- Çerrilë – Shkolla 9 – Vjeçare Gjerbës
- Rripan - Shkolla 9 – Vjeçare Ngraçan
- Ngraçie - Shkolla 9 – Vjeçare Visokë
- Belishovë - Shkolla 9 – Vjeçare Visokë
- Gadurovë - Shkolla 9 – Vjeçare Ninësh
- Ramaj – Shkolla 9 – Vjeçare Ninësh

-Në kompensimin e shpenzimeve të transportit në masën e sipërcituar përfshihen dhe nxënësit me AK të cilët nuk e zhvillojnë procesin mësimor pranë vendbanimit të tyre (edhe në linjat të cilat nuk janë parashikuar më sipër).

2. Shpenzimet do të mbulohen nga nga të ardhurat e veta të Bashkisë Mallakastër, artikulli 602.
3. Efektet finaciare fillojnë nga data 09.09.2024.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55, pika 6 e ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

KRYETAR

Nexhmi Sula

